

Vendim nr. 162, datë 22.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahimimi, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (F) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: FLAVIA BUSHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3907, datë 04.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Flavia Bushi është në proces gjyqësor për zgjidhjen e martesës me

bashkëshortin e saj, shtetasin S.B., me të cilin ka dy fëmijë të mitur. Këta të fundit, që prej muajit janar të vitit 2022, kanë qëndruar me të atin në banesën e tij, ndërkohë që kërkuesja i mbante ata gjatë fundjavave në një banesë të marrë me qira, sipas një grafiku të përcaktuar nga vetë bashkëshortët.

2. Në datën 10.07.2023 shtetasi S.B. ka shkuar të marrë fëmijët e mitur në banesën e kërkueses, ku kishin qëndruar për fundjavë, por nuk i është përgjigjur askush. Në vijim, nga verifikimet e kryera, ai ka mësuar se kërkuesja ishte larguar drejt Belgjikës bashkë me dy fëmijët e tyre, pa pëlqimin e tij. Për këtë arsye, shtetasi S.B. ka bërë kallëzim penal në Komisaratin e Policisë nr. 2, Tiranë dhe, më pas, ndaj kërkueses ka filluar një procedim penal për veprat penale “Marrja e padrejtë e fëmijës” dhe “Keqtrajtimi i të miturit”, të parashikuara nga nenet 127 dhe 124/b të Kodit Penal (KP). Në kuadër të këtij procedimi penal, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka caktuar ndaj kërkueses masën e sigurimit personal “Arresti në burg” dhe ajo është shpallur si në kërkim kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

3. Gjithashtu, shtetasi S.B. ka vënë në lëvizje edhe Ministrinë e Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për procedurat e kthimit të fëmijëve të mitur, në zbatim të Konventës “Për aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”, të ratifikuar nga shteti shqiptar. Në datën 01.12.2023 ai i është drejtuar edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesë për marrjen e masës urgjente për kthimin e fëmijëve të mitur në Shqipëri.

4. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 988/178 të regjistrimit themeltar, datë 25.01.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës për marrjen e masës urgjente, duke urdhëruar kërkuesen për kthimin menjëherë të fëmijëve të mitur në Shqipëri, pranë banesës së tyre në Tiranë.

5. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim shtetasi A.K., i ati i kërkueses, në cilësinë e përfaqësuesit të saj. Ky ankim i është nënshtruar kontrollit të pranueshmërisë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 988/178 të regjistrimit themeltar, datë 11.03.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se është bërë nga një person që nuk legjitimohet. Në vijim, ndonëse kërkuesja ka paraqitur ankim nëpërmjet përfaqësueses së saj E.K., Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 30-2024-4588 (729), datë 12.06.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të datës 11.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kurse për rekursin e paraqitur nga kërkuesja përmes avokates E.K., e pajisur me prokurë të posaçme, Kolegji Civil i Gjykatës së

Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3907, datë 04.11.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në rekurs nuk ishin ngritur shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC), që ta bënin të cenueshëm vendimin e kundërshtuar.

6. Në datën 04.03.2026, përmes shërbimit postar, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 19.03.2026.

II

Pretendimet e kërkeses

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi gjykata e shkallës së parë, e cila ka vendosur marrjen e masës urgjente për kthimin e fëmijëve, nuk e ka njoftuar për zhvillimin e gjykimit sipas përcaktimeve të KPC-së. Sipas kërkeses, gjykata e shkallës së parë nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe ajo nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor. Për sa kohë gjykata e shkallës së parë e ka zhvilluar gjykimin në seancë të hapur gjyqësore, kishte detyrimin të respektonte rregullat procedurale për njoftimin e palëve. Kjo shkelje nuk është korrigjuar në vijim as nga gjykatat më të larta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkeses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale,

shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet në dy prej kriterëve të legjitimitit, konkretisht në atë të *shterimit të mjeteve juridike efektive* dhe në atë *ratione materiae*.

10. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual është kundërshtuar vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses kundër vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta, të cilat kanë vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga i ati i saj ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që kishte disponuar për marrjen e masës urgjente të kthimit të fëmijëve të saj të mitur në Shqipëri. Megjithatë, në përmbajtje të ankimit, kërkuesja ka kundërshtuar edhe këto vendime të gjykatave të faktit për mospranimin e ankimit, si dhe vetë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për marrjen e masës urgjente.

12. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që ka vendosur marrjen e masës urgjente të kthimit të fëmijëve të mitur të kërkueses në Shqipëri, Kolegji vëren se ai nuk i është nënshtruar shqyrtimit në themel nga gjykatat më të larta, për shkak se ai vendim është ankimuar nga një person që nuk legjitimohej, pra nga babai i kërkueses, që do të thotë se vetë ajo nuk ka paraqitur ankim. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkueses që lidhen me mënyrën e zhvillimit të atij gjykimi, përfshirë pretendimin për mungesën e njoftimit,

nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare nga sistemi gjyqësor i zakonshëm. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses që lidhen drejtpërdrejt me procesin gjyqësor të zhvilluar për marrjen e masës urgjente nuk mund të merren në shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive. Kurse për sa i përket procesit gjyqësor që ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj këtij vendimi, Kolegji vlerëson se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës pas shterimit të mjeteve të zakonshme të ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

13. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga i ati i kërkueses ndaj vendimit të po asaj gjykate për marrjen e masës urgjente, me arsyetimin se ai nuk legjitimohej për të vepruar në emër dhe për llogari të saj në atë proces. Sipas asaj gjykate, nga përmbajtja e prokurës së lëshuar nga kërkuësja nuk rezultonte se ajo kishte synuar të caktonte një përfaqësues që do të vepronte në interes dhe për llogari të saj edhe në çështje të natyrës familjare. Ky vendim është bërë objekt kontrolli nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga përfaqësuesja e kërkueses, tashmë e pajisur me prokurë të posaçme, pasi ka vlerësuar se në të nuk ishin paraqitur shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

15. Referuar përmbajtjes së këtyre vendimeve, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë, pasi ka marrë në shqyrtim elementet formale të paraqitjes së ankimit, sipas dispozitave të KPC-së,

ka vlerësuar se personi që e kishte paraqitur atë nuk kishte tagra për të vepruar në emër dhe për llogari të kërkueses në çështjen konkrete. Ajo gjykatë ka parashtruar në vendimin e saj argumentet mbi të cilat ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Nga ana tjetër, gjykatat më të larta kanë marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të rekursit, tashmë të paraqitura nga një përfaqësues i pajisur me tagra të posaçme, dhe i kanë gjetur ato të pabazuara. Në këto kushte, çështja e ngritur nga kërkuësja lidhet, në thelb, me interpretimin e përmbajtjes dhe të kufijve të prokurës së datës 07.07.2023, me të cilën ajo i kishte dhënë disa tagra përfaqësimi të atit të saj, si dhe me zbatimin e rregullave procedurale për pranueshmërinë e ankimit, të cilat, si rregull, i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuësja nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme për të treguar se interpretimi i gjykatave të zakonshme mbi kufijtë e prokurës ka qenë tejet formalist, arbitrar ose joproporcional, në atë masë sa të ketë cenuar vetë thelbin e së drejtës së saj për akses në gjykatë ose për proces të rregullt ligjor. Po kështu, nga vendimet e kundërshtuara nuk rezulton që mënyra e interpretimit dhe e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme të jetë alogjike ose haptazi e pabazuar. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses kundër vendimeve gjyqësore që kanë vendosur mospranimin e ankimit dhe të rekursit janë haptazi të pabazuara.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.